



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva

Ministry of Health



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

Buletini vjetor i sëmundjeve ngjitëse

janar-dhjetor 2025

Shkurt, 2026

01 Janar - 31 Dhjetor, 2025**PËRMBAJTJA E BULETINIT**

- 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë periudhës janar - dhjetor 2025 dhe 2024*
- 2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, (të dhenat e agreguara)*
- 3. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, (të dhënat individuale)*
- 4. HIV/AIDS dhe Infeksionet seksualisht të transmetueshme*
- 5. Vaksinimi në Kosovë*
- 6. COVID-19 gjatë vitit 2025*
- 7. Rastet e vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse*
- 8. Epidemitë familjare dhe kolektive gjatë vitit 2025*
- 9. Rekomandimet*

Qëllimi i buletinit është:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit, kontrollës dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. Numri i rasteve dhe vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse, janar – dhjetor 2025 dhe 2024

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025 gjithsej janë raportuar **230,866 raste** të sëmundjeve ngjitëse me **Inc. 12,954.61/100,000** banorë. (Tab.1 dhe Aneksi.1).

Ky numër i sëmundjeve ngjitëse është më i ulët krahasuar me periudhën e njejtë të vitit 2024 me 277,296 raste të raportuara ose Inc. 15,559.8/100,000 banorë). Gjithashtu gjatë vitit 2025 janë raportuar 77 raste të vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse që janë një element shqetësues dhe kërkojnë vëmendje për përmirësimin e masave të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse. (Tab.1 dhe Tab.12)

Këto të dhëna tregojnë një tendencë të përgjithshme në ulje të disa sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, veçanërisht ato që lidhen me infeksionet respiratore dhe ato që përhapen përmes ujit dhe ushqimit.

Për dallim prej disa sëmundjeve zoonotike dhe sëmundjeve vaksinëparandaluese si (Morbilli), të cilat këtë vit kanë shënuar rritje.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, në Kosovë numër i konsiderueshëm i sëmundjeve ngjitëse janë raportuar në numër më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Numër më i ulët i rasteve të raportuara shihet te sëmundjet e formës së agreguar si: pneumonitë, Influenca sezonale, dhe diaretë akute (Tabela 1 dhe 2, Grafikoni 1). Mbikëqyrja e COVID-19 dhe influencës sezonale është kryer në baza javore, gjatë së cilës është përgatitur buletini javor i situatës epidemiologjike që përfshin të dhëna për SARS-CoV-2, Influcencën, RSV-në, patogenët tjerë respiratorë si dhe të dhënat e mbikëqyrjes virologjike

Raportimi i një numri të konsiderueshëm të infeksioneve gastrointestinale, që përhapen përmes ushqimit dhe ujit të kontaminuar, si dhe nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me persona të infektuar, evidenton nevojën për ndërhyrje të qëndrueshme dhe të koordinuara, forcim itëmasave të sigurisë ushqimore, aktivitete të edukimit shëndetësor për higjienën personale, si dhe përmirësim i kushteve higjiëno-sanitare në mjedise publike dhe private.”

Sa i përket zoonozave dhe sëmundjeve që barten me vektor, gjatë kësaj periudhe vërehet tendencë në rritje të rasteve të Boreliozës dhe Tularemisë, krahasuar me vitin 2024. Kjo prirje sinjalizon rrezikun e mundshëm për rishfaqjen e këtyre sëmundjeve dhe kërkon vëmendje të shtuar për masat parandaluese dhe fuqizim të bashkëpunimit ndërsektorial sipas qasjes “Një shëndet”.

Në krahasim me periudhën paraprake, Brucelloza dhe Virusi i Nilit Perëndimor (WNV) kanë shënuar ulje të incidencës, ndërsa gjatë kësaj periudhe është raportuar një rast i konfirmuar i etheve hemorragjike me sindromë renale, i regjistruar nga zonat endemike.

Sëmundjet vaksinëpreventabile si parotiti dhe pertussisi kanë shënuar një rënie krahasuar me periudhën paraprake. Ndërkohë, gjatë këtij viti është regjistruar një rritje e numrit të rasteve të fruthit, duke reflektuar një situatë epidemiologjike të ngjashme me atë të rajonit, i cili është përballur me shpërthime epidemike.

Rastet me IST këtë vit tregojnë tendencë në ulje të numrit të rasteve të raportuara përderisa HIV/AIDS raportohet me numër me të lartë gjatë vitit 2025.

NUMRI I RASTEVE DHE INCIDENCA E SËMUNDJEVE NGJITËSE NË KOSOVË, JANAR - DHJETOR TË VITIT 2025 DHE 2024

Tabela 1. Rastet/Incidenca e sëmundjeve ngjitëse 2025 dhe 2024

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse janar - dhjetor, 2025 dhe 2024				
Sëmundjet/shkaktarët	janar-dhjetor, 2025		janar-dhjetor, 2024	
	Nr.	Incidenca / 100,000	Nr.	Incidenca / 100,000
COVID-19	125	7.01	1735	97.36
ITPR - Pneumonia/ARI	17057	957.12	17646	990.17
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	211	11.84	207	11.62
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	126316	7087.98	138825	7789.90
Influenca A	488	27.38	297	16.67
Influenca A H3	32	1.80	3	0.17
Influenca A H1 pdm09	12	0.67		
Influenca B	407	22.84	40	2.24
Influenca B/Victoria		0.00	1	0.06
RSV	312	17.51	177	9.93
Diarea acute	77176	4330.58	108077	6064.54
Variçela	4643	260.53	6536	366.76
Sindromi meningjeal	165	9.26	155	8.70
EHSV	1	0.06	2	0.11
EHHK		0.00	1	0.06
Helmimet me ushqim	1079	60.55	1102	61.84
Rota virus	84	4.71	93	5.22
Salmonella enteritidis	33	1.85	46	2.58
Shigelloza		0.00		0.00
Adenovirus	29	1.63	21	1.18
Enterovirus	14	0.79	16	0.90
Norovirus	1	0.06	3	0.17
Gastroenterokolitet	792	44.44	764	42.87
Hepatiti akut A	2	0.11	2	0.11
Hepatiti akut B	23	1.29	40	2.24
Hepatiti akut C	8	0.45	3	0.17
E.coli patogjene		0.00	4	0.22
Parotiti epidemik	18	1.01	32	1.80
Morbilli**	72	4.04	1	0.06
Pertussis	29	1.63	209	11.73
Tularemia	12	0.67	10	0.56
Brucellosis	40	2.24	55	3.09
Rubella	2	0.11		0.00
Leishmaniazë	3	0.17	1	0.06
Leptospirosis		0.00	3	0.17
Toxoplazmozis	7	0.39	6	0.34
Legionella	1	0.06	0	0.00
WNV	1	0.06	7	0.39
Malarie**		0.00	4	0.22
Sëmundja Lyme	19	1.07	8	0.45
TB	515	28.90	350	19.64
HIV/AIDS	37	2.08	34	1.91
IST	313	17.56	400	22.45
Echinococcus	3	0.17	5	0.28
Mpox**		0.00	1	0.06
Enterobius vermicularis	2	0.11		0.00
Giardia	26	1.46	30	1.68
Entameba Hystolitica	1		2	
Clostridium difficile	21	1.18		0.00
Infeksionet streptokoksike të grupit A	92	5.16	119	6.68
*Sëmundjet tjera ngjitëse	642	36.02	223	12.51
Gjithsej	230866	12954.61	277296	15559.8

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

2. Sëmundjet ngjitëse të raportuara gjatë vitit 2025

(Të dhënat e agreguara)

Në periudhën janar-dhjetor 2025, grupi i sëmundjeve me të dhëna të agreguara ka shënuar një numër total prej 225, 192 raste, duke paraqitur një ulje prej 16.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Përsa i përket shpërndarjes së rasteve, Influenca sezonale/ILI raportohet me numrin më të lartë të rasteve, me 126,316 raste, apo Inc.7,087.98 raste për 100,000 banorë. Kjo është një përqindje e konsiderueshme e rasteve të raportuara me përfaqësim prej (56.09%) nga ky grup i sëmundjeve .

Po ashtu, Diarrea akute është një tjetër sëmundje dominuese, me 77,176 raste të raportuara, ose Inc.4330.58 raste për 100,000 banorë, që përbën 34.27 % të rasteve të raportuara nga ky grup sëmundjesh.

Pneumonitë apo Infeksionet e Rrugëve të Poshtime të Frymëmarrjes (ARI) janë raportuar me 17,057 raste, apo Inc. 957.12 raste për 100,000 banorë. Ky numër është lehtësisht më i ulët krahasuar me vitin 2024, ku ishin raportuar 17,646 raste, apo Inc.990.17 raste për 100,000 banorë.

Nga ana tjetër, Variçella ka treguar një ulje të ndjeshme të numrit të rasteve të raportuara, me 4,643 raste ose 260.53 raste për 100,000 banorë. Kjo përbën një ulje prej 28.96% krahasuar me vitin 2024, kur ishin regjistruar 108,077 raste.


Në përgjithësi, këto të dhëna sugjerojnë një ngarkesë të lartë shëndetësore, veçanërisht për sëmundjet ngjitëse të traktit respiratorë dhe gastrointestinal, ndërkohë që variçella ka treguar një rënie të dukshme. Rastet e raportuara nga trakti respiratorë kryesisht regjistrohen në tremujorin e parë të vitit) për të vazhduar me muajin tetor kur edhe fillon intensifikimi i aktiviteteve gjatë sezonës së gripit dhe mbikëqyrjes më intensive nga institucionet shëndetësore.

Numri i lartë i rasteve të raportuara me Diare akute mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë, ndërprerjet e ujit dhe kycjet ilegale në ujësjellës, mungesa e kanalizimit, dispozicioni i mbeturinave jo i rregullt, kushtet e dobëta ekonomike dhe higjienike të cilat në Kosovë janë ende evidente. (Tab.1 dhe 2).

Tabela 2. Rastet e sëmundjeve ngjitëse (të dhënat e agreguara) në Kosovë, 2025


SËMUNDJA KOMUNA	<i>Pneumoni a/ARI</i>	<i>ILI</i>	<i>Diarrhea ac</i>	<i>Variçella</i>	<i>Totali</i>
DEÇAN	51	2115	1088	63	3317
DRAGASH	240	1359	917	25	2541
DRENAS	738	1355	697	68	2858
F. KOSOVË	223	3724	1039	128	5114
FERIZAJ	239	4446	3119	178	7982
GJAKOVË	269	1877	1246	80	3472
GJILAN	239	6467	3774	254	10734
GRAÇANICË					0
H. I ELEZIT	96	1050	322	24	1492
ISTOG	75	1936	1001	13	3025
JUNIK	3	484	159	9	655
KAÇANIK	44	975	930	69	2018
KAMENICË	4	5260	2381	5	7650
KLINË	353	1460	1282	154	3249
KLLOKOT					0
LEPOSAVIQ					0
LIPJAN	8	533	503	29	1073
MALISHEVË	32	1858	988	70	2948
MAMUSHË	33	570	478	64	1145
MITROVICË	638	9198	7820	364	18020
MITROVICË E VERIUT					0
N. BËRDË	62	270	179		511
OBILIQ	67	1408	858	95	2428
PARTESH					0
PEJË	196	10200	6275	264	16935
PODUJEVË	248	5796	1855	250	8149
PRISHTINË	11848	35857	18757	1288	67750
PRIZREN	442	10764	10351	583	22140
RAHOVEC	127	837	847	42	1853
RANILLUG					0
SHTËRPCE					0
SHTIME	181	3254	972	42	4449
SKËNDERAJ	67	1044	1260	69	2440
SUHAREKË	149	7306	4547	155	12157
VITI	46	3478	1871	106	5501
VUSHTRRI	339	1435	1660	152	3586
Z. POTOK					0
ZVEÇAN					0
TOTALI	17057	126316	77176	4643	225192

Grafikoni 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse 2025, të dhënat e agreguara të shprehura në përqindje




Me përcjellje të rregullt të situatës epidemiologjike me Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI) është vërejtur se Intensiteti i Influencës sezonale për sezonën 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026. (Graf.2).

Grafikoni 2. Ecuria e Influencës sezonale (ILI) në Kosovë, sezona 2021/2022-2025/2026




Numri më i lartë i rasteve raportohet nga: komuna e Prishtinës (35,857 raste), Prizrenit dhe Pejës me (10,764 respektivisht 10,200 raste) derisa numër me të ulët të rasteve raportojnë komunat: Novobërdë me (270 raste) dhe Junik (484 raste) kurse sipas Incidencës, numër më të lartë kanë komunat: Prishtinë, Kamenicë dhe Mitrovicë. (Tab.2 dhe Graf. 3)

Grafikoni 3. Rastet ILI sipas komunave dhe Incidenca në Kosovë, janar-dhjetor 2025




Rastet e raportuara me (ILI) kryesisht regjistrohen në tremujorin e parë të vitit për të vazhduar me muajin tetor, nëntor kur edhe fillon intensifikimi i aktiviteteve gjatë sezonës së gripit dhe mbikëqyrjes më intensive nga Institucionet shëndetësore. (Graf.4).

Grafikoni 4. Numri i rasteve me ILI dhe Incidenca/100,000 banorë sipas muajve, Kosovë 2025



Në grupin e sëmundjeve që raportohen me të dhëna të agreguara sipas grup-moshës (Graf. 5), më e atakuar, është grup-mosha 5-49 vjeç për: influencë sezonale, diare akute dhe variçellë kurse numri më i ulët i rasteve për ILI raportohet nga grup-mosha 0-4 vjeç për dallim nga pneumonitë, diaretë akute dhe variçella, ku numri më i ulët i rasteve raportohet nga grup-mosha mbi 50 vjeç.

Grafikoni 5. Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, 2025, sipas grup-moshës (të dhënat e agreguara)




3. Sëmundjet ngjitëse të raportuara në Kosovë, 2025 (Të dhënat individuale)

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, nga grupi i sëmundjeve ngjitëse të cilat raportohen në formën individuale janë regjistruar gjithsej 5,674 raste apo Inc.318.39/100,000 banorë. Kjo tregon një ulje prej 10.34% krahasuar me vitin 2024, ku ishin raportuar 6,328 raste të sëmundjeve ngjitëse me formën individuale apo Inc. 355.08 për 100,000 banorë.

Në raport me përqindjen e rasteve të raportura në numër më të lartë janë raportuar raste me Helmimet me ushqim me 1,079 raste apo 27% nga numri i gjithmbarshëm i rasteve me formën individuale pasuar nga Influenca A me 532 raste apo 14% dhe Tuberkulozi me 515 raste apo 13% e rasteve nga numri i gjithmbarshëm i rasteve të raportuara me formën individuale (Graf.6).

Grafikoni 6. Rastet e sëmundjeve ngjitëse, 2025 të dhënat individuale të shprehura në përqindje




Sipas komunave vërehet se numri më i lartë raportohet nga: komuna e Prishtinës (1,508 raste), komuna e Vushtrrisë dhe Mitrovicës (me 742 respektivisht 462 raste).

Numër me të ulët të rasteve me sëmundje ngjitëse raportohen nga komuna e Graçanicës dhe Parteshit me (2 respektivisht me 1 rast). (Tab.3).

Sëmundjet respiratore dhe Tuberkulozi në Kosovë, 2025


Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influençës – IKSHPK, gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, janë testuar gjithsej 4,048 mostra nga qendrat sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga 4,048 mostrat e testuara në Influençë dhe patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar 939 raste me influencë A dhe B (pozitiviteti 23.2%). Sipas tipit: me Influençë A (532 raste apo 56.7%) dhe Influençë B (407 raste apo 43.3%). Sipas komunave: Prishtinë (321 raste), Mitrovicë (303 raste), Fushë Kosovë (42 raste), Podujevë (27 raste), Vushtrri (27 raste), Lipjan (26 raste), Ferizaj (24 raste), Drenas (22 raste), Malishevë (21 raste), Skenderaj (15 raste), Suharekë (15 raste), Obiliq (15 raste), Pejë (14 raste), Prizren (12 raste), Gjilan (10 raste), Gjakovë (8 raste), Klinë (7 raste), Rahovec (7 raste), Shtime (5 raste), Viti (5 raste), Hani i Elezit (3 raste), Kaçanik (3 raste), Deçan (2 raste), Dragash (2 raste), Novobërdë (2 raste) dhe me një rast komuna e Istogut. Nga mostrat pozitive me influencë A dhe B, shihet se grupmosha më e atakuar është ajo 0–4 vjeç me (412 raste), 5–14 vjeç me (283 raste), 15-34 vjeç (101 raste), 35-50 vjeç (53 raste), 51-64 vjeç (46 raste) dhe mbi 65+ me (44 raste). Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 434 mostra me Human Rhinovirus (10.7%), 312 mostra me Virusin Sincial (RSV) (7.7%), 304 mostra me Human Adenovirus (7.5%), 68 mostra me Human Metapneumovirus (1.7%) dhe 55 mostra me Parainfluenca Virus (1.4%). (Graf. 1). Rastet pozitive në virusin sincial (RSV) sipas komunave dhe grupmoshës : Prishtinë (126 raste), Fushë Kosovë (40 raste), Ferizaj (20 raste), Podujevë (15 raste), Malishevë (11 raste), Vushtrri (10 raste), Drenas (9 raste), Lipjan (8 raste), Shtime (7 raste), Klinë (6 raste), Mitrovicë (6 raste), Obiliq (6 raste), Pejë (6 raste), Gjilan (5 raste), Kaçanik (5 raste), Prizren (5 raste), Gjakovë (4 raste), Skenderaj (4 raste), Suharekë (4 raste), Viti (4 raste), Hani i Elezit (3 raste), Rahovec (3 raste), Deçan (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Istog, Kamenicë dhe Novobërdë. Sipas grupmoshës, 277 raste i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç, 15 raste grup-moshës 5-14 vjeç, 6 raste grup-moshës 15-34 vjeç, 2 raste grup-moshës 35-50 vjeç, 4 raste grup-moshës 51-64 vjeç dhe 8 raste grup-moshës 65+ vjeç. (Graf. 7).

Grafikoni 7. Mbikëqyrja virologjike me Influcencën A, B, (RSV) dhe patogjenët tjerë respiratorë sipas muajve, 2025



Sipas subtipit: me Influcencë A të pasubtipizuar janë 488 raste (52%), me subtipin AH3 janë 32 raste (3%), me subtipin A(H1N1 pdm09) 12 raste (1%), me subtipin Influcencë B bbVictoria 8 raste (1%) dhe Influcencë B të pasubtipizur janë 399 raste (43%). (Graf.8).

Grafikoni 8. Influcenca A dhe B sipas sub-tipit në Kosovë, janar-dhjetor 2025



Gjate periudhës janar-dhjetor 2025, nga 939 rastet pozitive në Influcencë A dhe B, 279 prej tyre ishin hospitalizuar në Klinikën Infektive, 82 në Klinikën e Pediatrie, 36 prej tyre u trajtuan në mënyrë ambulantore, 55 në Spitalin e Përgjithshëm Mitrovicë, 2 në Klinikën e Hematologjisë dhe 1 në Klinikën e Endokrinologjisë.

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2025, përmes raportimit në kohë reale nga Kl. Infektive dhe përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN), u raportuan gjithsej 211 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan, 21 mostra pozitive në Influcencë A, 15 mostra pozitive në Human Adenovirus, 13 mostra pozitive në SARS-CoV-2, 10 mostra pozitive në Human Rhinovirus, 8 mostra pozitive në Virusin Sincicial (RSV), 3 mostra pozitive në Metapneumovirus dhe 2 mostra pozitive në Parainfluenca Virus.

Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup-moshës është : mbi 65 vjeç (80 raste) apo 37.9%, 0-4 vjeç (66 raste) apo 31.3%, 51-64 vjeç (26 raste) apo 12.3%, 35-50 vjeç (19 raste) apo 9%, 15-34 (12 raste) apo 5.7% dhe 5-14 vjeç (8 raste) apo 3.8%.

Tabela 4. Të dhënat sipas grup-moshës te rastet me SARI, 2025

Grup-mosha	Numri i rasteve	% e rasteve	Mosha mesatare
0–4 vjeç	66	31.3%	2
5–14 vjeç	8	3.8%	9.5
15–34 vjeç	12	5.7%	25
35–50 vjeç	19	9.0%	42
51–64 vjeç	26	12.3%	57.5
65+ vjeç	80	37.9%	75
Totali	211	100%	41.7

Siç shihet edhe në tabelë grupmosha 0–4 vjeç përbën 31.3% të totalit të rasteve, ndërsa grupmosha 65+ vjeç përbën 37.9%. Grupi me prevalencën më të lartë të rasteve është 65+ vjeç (37.9%), kurse përqindja më e ulët e rasteve është te grup-mosha 5–14 vjeç (3.8%). Mosha mesatare e pacientëve SARI ishte 41.7 vjeç. Analiza e shpërndarjes sipas grupmoshave tregon një shpërndarje më të qëndrueshme në grupmoshat e mesme ndërsa prevalenca më e lartë është vërejtur te grupmoshat, 0–4 vjeç dhe 65+ vjeç, duke reflektuar rrezikun më të madh për hospitalizim në këto grupe.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (76 raste), Fushë Kosovë (16 raste), Vushtrri (14 raste), Gjakovë (10 raste), Podujevë (10 raste), Ferizaj (9 raste), Mitrovicë (9 raste), Drenas (8 raste), Lipjan (7 raste), Malishevë (7 raste), Gjilan (6 raste), Prizren (5 raste), Rahovec (5 raste), Klinë (4 raste), Deçan (3 raste), Pejë (3 raste), Viti (3 raste), Istog (2 raste), Kaçanik (2 raste), Mamushë (2 raste), Obiliq (2 raste), Skenderaj (2 raste), Suharekë (2 raste) dhe me nga një rast

komunat si : Hani i Elezit, Kamenicë, Novobërdë dhe Shtime. Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 53.6% e pacientëve ishin meshkuj, ndërsa 46.4% ishin femra, duke reflektuar një mbizotërim të lehtë të gjinisë mashkullore në totalin e rasteve SARI të hospitalizuar gjatë vitit 2025.

Nga të gjitha rastet SARI, 46 apo 21.8% prej tyre janë të vaksinuar me vaksinën kundër COVID-19 dhe 16 apo 7.6% e tyre janë të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Klinika Infektive, mbetet qendra me më së shumti pranime dhe hospitalizime, nga të gjitha qendrat sentinel në Kosovë, me 59.2% të rasteve SARI pasuar nga Klinika e Pediatriisë me 40.8% të rasteve SARI.

Përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN), gjatë periudhës 01 janar deri më 31 dhjetor 2025, janë raportuar gjithsej 515 raste të TB në Kosovë me Incidencë 28.9/100.000 banorë, të klasifikuara sipas formës së sëmundjes dhe historisë së trajtimit. Krahasuar me vitin paraprak, kemi një rritje prej 47.1% të raportuara, ku gjatë vitit 2024 të raportuara ishin 350 raste me Incidencë 19.3/100.000 banorë. Nga 515 raste të raportuara gjatë vitit 2025, pjesa dërrmuese e tyre 482 raste (93.5%), janë raste të reja dhe jo recidive ose dështimet e trajtimit. Forma më e shpeshtë e raportuar ishte TB pulmonare, veçanërisht TB pulmonare e konfirmuar bakterial, me 238 raste (46.2%), e ndjekur nga TB pulmonare e konfirmuar klinikisht me 185 raste (36.9%). Rastet e TB-së ekstra-pulmonare përbëjnë një përqindje më të ulët, me gjithsej 92 raste (17.8%), nga të cilat 81 raste ishin të konfirmuara klinikisht dhe 11 raste të konfirmuara bakterial. kjo përqindje e konfirmimit mikrobiologjik të rasteve flet se konfirmimi laboratorik i sëmundjes është në nivel të ulët krahasuar me standardet të OBSH-së. Kjo tregon që rastet e TB të konfirmuara bakteriologjikisht janë në % më të ulët krahasuar me rastet e konfirmuara klinikisht.

Në total, format pulmonare përbëjnë shumicën dërrmuese të rasteve, çka është në përputhje me profilin epidemiologjik të TB-së dhe potencialin më të lartë për transmetim në komunitet.

Sa i përket historisë së trajtimit, janë identifikuar 25 raste recidive, të cilat janë raportuar kryesisht në format pulmonare, veçanërisht në TB pulmonare të konfirmuar bakteriologjikisht. Janë raportuar gjithashtu raste sporadike të dështimit të trajtimit (1 rast) dhe humbjes nga përcjellja (2 raste), ndërsa 2 raste janë klasifikuar si pacientë të trajtuar më parë pa dokumentacion të plotë të historisë së trajtimit. Vetëm 1 rast është regjistruar pa histori të njohur të trajtimit të mëparshëm, kurse 2 raste janë të pakategorizuara.

Në tërësi, të dhënat tregojnë se barra e TB-së dominohet nga raste të reja dhe nga format pulmonare, me një numër relativisht të ulët të rasteve të trajtuara më parë, recidive ose me histori të komplikuar trajtimi. Kjo sugjeron një situatë epidemiologjike relativisht të qëndrueshme, por thekson rëndësinë e vazhdimit të diagnostikimit të hershëm, konfirmimit bakterial dhe ndjekjes së rreptë të trajtimit për të parandaluar transmetimin dhe rikthimin e sëmundjes. Nga gjithsej 515 raste të tuberkulozit të raportuara gjatë periudhës së raportimit, 285 raste (55.3%) i përkasin meshkujve dhe 230 raste (44.6%) femrave, duke treguar një

mbizotërim të lehtë të rasteve tek meshkujt. Rastet janë të shpërndara në të gjitha grupmoshat, megjithatë barra më e madhe e sëmundjes vërehet tek të rriturit dhe të moshuarit.

Numri më i lartë i rasteve është regjistruar në grupmoshën 65–69 vjeç me (61 raste), e ndjekur nga grupmosha 60–64 vjeç me (57 raste), 55–59 vjeç me (54 raste), 25–29 vjeç me (53 raste). Këto të dhëna tregojnë se incidenca e TB-së rritet me moshën, veçanërisht pas moshës 50 vjeç, çka lidhet me faktorë të rrezikut si sëmundjet bashkëshoqëruese, imuniteti i ulur dhe ekspozimi i mëparshëm. Tek meshkujt, rastet janë më të shprehura në grupmoshat mbi 55 vjeç, ndërsa tek femrat shpërndarja është më e baraspeshuar, me një numër relativisht të lartë rastesh edhe në grupmoshat 25–29 dhe 65–69 vjeç. Gjatë periudhës së raportimit janë regjistruar gjithsej 515 raste të tuberkulozit në nivel vendi, të shpërndara në pothuajse të gjitha komunat. Shpërndarja gjeografike e rasteve tregon përqendrim më të lartë të TB-së në komunat me popullsi më të madhe dhe densitet më të lartë, veçanërisht në Prishtinë (93 raste), Ferizaj (44 raste), Prizren (43 raste), Lipjan (34 raste) dhe Malishevë (31 raste). Këto komuna përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të barrës totale të sëmundjes.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve me TB, në të gjitha komunat dominojnë rastet e reja me 482 raste (93.5%), ndërsa rastet recidive dhe ato me histori të komplikuar trajtimi janë të pakta. Rastet recidive janë raportuar kryesisht në Prishtinë dhe Prizren, ndërsa rastet e trajtuara pas humbjes nga përcjellja dhe pas dështimit të trajtimit janë identifikuar në një numër shumë të kufizuar komunash.

Në disa komuna janë raportuar raste pa histori të njohur të trajtimit të mëparshëm, më së shumti në Pejë, Prizren, Deqan dhe Prishtinë, gjë që nënvizon nevojën për përmirësim të dokumentimit të historisë së trajtimit dhe verifikimit epidemiologjik të rasteve. Komunat më të vogla kanë raportuar një numër të ulët rastesh, shpesh të izoluar.

Në tërësi, shpërndarja komunale e rasteve të TB-së reflekton një situatë epidemiologjike heterogjene, me përqendrim të rasteve në qendrat urbane dhe mbizotërim të rasteve të reja, duke theksuar rëndësinë e forcimit të mbikëqyrjes, diagnostikimit të hershëm dhe ndjekjes së trajtimit në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 515 raste të tuberkulozit, për të cilat është raportuar rezultati i mjekimit sipas kategorive të standardizuara. Nga totali, 307 raste (60%) janë klasifikuar si “i pa vlerësuar”.

Numri i rasteve që rezultuan të shëruar është 70 raste (13.6%), ndërsa 105 raste (21%) kanë përfunduar trajtim të kompletuar. Vetëm 1 rast është raportuar si trajtim i dështuar, dhe 16 raste janë regjistruar si të humbur nga përcjellja. Ndërsa 7 raste janë raportuar si vdekje jo nga TB, kurse 1 rast është raportuar si vdekje nga TB.

Shpërndarja sipas grupmoshave dhe gjinisë tregon se shumica e rasteve të pa vlerësuar I takojnë grupmoshës 25–69 vjeç, ndërsa numri i pacientëve të shëruar dhe të trajtuar plotësisht është më

i përqendruar tek grupmoshat 20–64 vjeç. Rastet e humbura nga përcjellja janë të shpërndara në mënyrë sporadike në të gjithë grupmoshat.

Këto të dhëna tregojnë nevojën për forcimin e gjurmimit të pacientëve dhe mbikëqyrjes pas trajtimit, për të rritur shkallën e shërimit dhe për të reduktuar humbjen nga ndjekja.

Sindroma meningjeale

Gjatë vitit 2025 janë raportuar gjithsej 165 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 9.25/100 000 banorë), prej tyre 111 raste me Meningjit ac. serosa, 24 raste me Meningoencephalit akut, 17 raste me Meningjit purulent, 6 raste me Meningoencephalitis purulenta, 3 raste me Meningitis Meningococcica, 2 raste me Mumps Meningitis, 1 rast me Sepsë Meningokoksike dhe 1 rast me Meningoencephalit Tuberkular. Ky numër i rasteve të raportuara nuk paraqet rritje sinjifikante, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ku janë raportuan 155 raste. (Tab.5)


Tabela 5. Sindroma meningjeale në Kosovë, sipas diagnozës klinike dhe komunave, janar- dhjetor, 2025

Komuna	Sepsis meningococcica	Meningoencephalitis purulenta	Mening purulenta	Meningitis ac. serosa	Mumps Meningitis	Meningoencephalitis ac.	Meningitis meningococcica	Meningitis Tb	Meningoencephalitis Tb	Total
DEÇAN				1		1		1		3
DRAGASH										0
FERIZAJ			3	6		3	1			13
FUSHË KOSOVË			2	8	1					11
GJAKOVË				3		1				4
GJILANI		1	1	2		2				6
DRENAS				2		4				6
ISTOG				1						1
KACANIK			1	2						3
KAMENICË				2						2
JUNIK										0
KLINE			2	5						7
LIPJAN				6		2				8
MITROVICË			1	6		2				9
NOVOBËRD										0
OBILIQ						1				1
PEJE				4						4
PODUJEVË		3		4		1				8
PRISHTINË	1		5	41	1	3				51
PRIZREN		1	1	3		1				6
MALISHEVË				2			1			3
RAHOVEC				1						1
SHTIME		1		1						2
SKENDERAJ			1							1
SUHAREKË				1						1
VITI				4						4
Graçanicë						1				1
VUSHTRRI				6		2	1			9
ZUBIN POTOK										0
SHTERPCE										0
HANI I ELEZIT										0
MAMUSHË										0
Total	1	6	17	111	2	24	3	1	0	165

Hulumtimit epidemiologjik i janë nënshtruar të gjitha rastet e hospitalizuara në ShSKUK - Klinika Infektive, Klinika e Pediatriisë dhe Spitalet Rajonale.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, sipas komunave rezultojnë se numri më i madh i rasteve është raportuar nga komuna e Prishtinës (51 raste), Ferizaj (13 raste), Fushë Kosovë (11 raste), Mitrovicë dhe Vushtrri me nga (9 raste), Podujevë dhe Lipjan me nga (8 raste), Klina (7 raste), Prizreni, Gjilani dhe Drenasi me nga (6 raste), kurse komunat tjera me numër më të ulët, ndërsa Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komunat: Fushë Kosovë me 32/100,000 banorë, Prishtinë me 26/100,000 banorë, Klina me 18/100,000 banorë (Graf.9)

Grafikoni 9. Numri i rasteve me Sindromë meningjeale sipas komunave, Incidenca dhe vdekjet/100.000 banorë, janar- dhjetor 2025




Gjatë këtij viti janë raportuar 9 raste të vdekjes, prej tyre 6 raste me dg. Meningoencephalitis acuta (2 raste në Drenas, kurse me nga 1 rast komunat si: Mitrovicë, Ferizaj, Deçan dhe Graçanicë), 3 raste me dg. Meningoencephalitis purulenta (2 raste Podujevë dhe 1 rast Gjilan). Ky numër i rasteve të vdekjeve, paraqet ulje prej 2 herë apo (50%) krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ku janë raportuar 18 raste të vdekjes nga Sindroma Meningjeale.

Ecuria e sëmundjes sipas grup-moshave

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultojnë se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç me 46.6% (77 raste), grup moshë 60-69 vjeç me 11% (18 raste), grup moshat 10-19 me 11% (17 raste), grup moshë 70-79 vjeç me 8.48 % (me 14 raste), grup moshë 50-59 vjeç me 6.66% (me 11 raste), 30-39 me 6.6% (me 10 raste), kurse grup moshat 20-29 vjeç

dhe 40-49 vjeç me 4.84 % (me nga 8 raste) dhe mbi 80 vjeç me 1.21% apo 2 raste. Sipas incidencës, grup moshë më e prekur është 0-9 vjeç me 29/100,000 banorë.

Grafikoni 10. Numri i rasteve me Sindromë meningjeale dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor 2025



Ecuria e sëmundjes sipas gjinisë

Gjatë kësaj periudhe me Sindromë Meningjeale, sipas gjinisë rezulton se kemi 58.18% (96 raste) të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore 41.82% (69 raste)

Ecuria e sëmundjes sipas shkaktarit të izoluar në likuor

Diagnostifikimi i hershëm i të sëmurve nga Meningjiti ka randësi të madhe epidemiologjike, pasi ofron mundësinë e ndërmarrjes së masave të shpejta profilaktike dhe epidemiologjike.


Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 92 shkaktarët në Lëngun cerebrospinal (LCS) prej tyre; në 21 raste me Human Herpes Virus-7, në 13 raste është izoluar Streptococcus Pneumoniae, në 11 raste është izoluar Epstein Bar Virusi, në 9 raste është izoluar Variçela Zoster Virus, kurse shkaktarët e tjerë janë izoluar në numër më të ulët. (Tab.6)

Tabela 6. Shkaktari i izoluar në likuor, janar-dhjetor 2025

Shkaktari i izoluar në likuor, 2025	
Izolate	Nr.
<i>Neisseria meningitidis</i>	4
<i>Streptococcus pneumoniae</i>	13
<i>Streptococcus sanguinis</i>	1
<i>Listeria monocytogenes</i>	1
<i>Enterococcus faecalis</i>	1
<i>Acinetobacter baumannii</i>	1
<i>Cryptococcus neoformans</i>	1
<i>Staphylococcus coagulaza negative</i>	2
<i>Haemophilus influenzae</i>	2
Citomagalovirus	2
Mumps Virus	2
Human Enterovirus	4
Human Adenovirus	2
Human parechoviruses	1
HHV 1	4
HHV 2	1
HHV 6	5
HHV 7	21
HHV 8	1
Human parvovirus B 19	3
Varicela Zoster Virus	9
Epstein Barr Virus	11
Totali	92

Nëse krahasojmë paraqitjen e rasteve me Sindromë Meningeale përgjatë muajve të vitit 2025 me muajt e vitit 2024, kemi numër më të ulët të rasteve të raportuara gjatë muajit maj dhe dhjetor të vitit 2025. Numër më i lartë i rasteve gjatë vitit 2025, është raportuar përgjatë muajit nëntor me 22 raste me (Mb. 1.23/100 000 banorë) dhe muajit korrik me 19 raste me (Mb. 1.06/100.000 banorë). (Graf.11).

Grafikoni 11. Sindroma Meningjeale në Kosovë, krahasuar sipas muajve gjatë vitit 2024-2025



Zoonozat dhe sëmundjet që përhapen me vektorë

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar gjithsej 40 raste pozitive me Brucellozë, apo Incidencë 2.18 në 100,000 banorë, 12 raste pozitive me Tularemi, apo 0.65 në 100,000 banorë, 7 raste me Toxoplazmozë apo 0.38 në 100,000 banorë dhe 3 raste me Echinococcus apo 0.17/100,000 banorë.


Rastet e konfirmuara me Brucellozë raportohen nga 12 komuna dhe 28 vatra. Komunat më të prekura janë Prizreni me 15 raste dhe Rahoveci me 8 raste, pasuar nga Dragashi me 4 raste dhe Podujeva me 3 raste. Komuna të tjera si Istogu dhe Vushtrria kanë regjistruar nga 2 raste, ndërsa disa komuna të tjera, si Prishtina, Malisheva, Mamusha, Lipjani, Shtimja dhe Peja kanë raportuar vetëm nga një rast.

Bruceloza ka ndikuar kryesisht në zona të cilat janë më të lidhura me aktivitete bujqësore dhe blegtorale, ku ka një mundësi më të madhe të kontaktit me kafshët, veçanërisht në komunat si Rahoveci, Prizren dhe Dragashi. Kjo mund të shpjegohet me karakteristikat e këtyre komunave, ku shumica e popullsisë është e angazhuar në bujqësi dhe blegtori. (Kartogrami dhe Graf.12).

Tularemia, është raportuar me 12 raste, ku sipas komunave: Podujevë, Drenas, Ferizaj, Vushtrri me nga 2 raste, Lipjani, Obiliqi Skënderaj dhe Fushë Kosova me nga një rast të raportuar

Kjo pasqyron një rënie të rasteve të Brucelozës në krahasim me vitin 2024, ku kishim 55 raste të Brucelozës dhe një rritje të lehtë të numrit të rasteve me Tularemi, me 10 raste në 2024.

Vatrat sipas rasteve të raportuara me Brucellozë në Kosovë, 2025




Sipas të dhënave, numri më i lartë i rasteve të Brucelozës është regjistruar në grupmoshën 50–59 vjeç, me gjithsej 11 raste, e shoqëruar edhe me incidencën më të lartë specifike (5.43 raste/100,000 banorë). Pas kësaj grupmoshe, vërehet një numër i konsiderueshëm rastesh edhe në grupmoshën 30–39 vjeç me 9 raste, si dhe në grupmoshën 60–69 vjeç me 6 raste.

Sa i përket Tularemisë, numri më i lartë i rasteve është regjistruar gjithashtu në grupmoshën 50–59 vjeç, me 3 raste dhe incidencë specifike 1.48/100,000 banorë. Më pas renditen grupmoshat 10–19 vjeç, 20–29 vjeç, 30–39 vjeç dhe 60–69 vjeç, secila me nga 2 raste ose më pak. Nuk janë raportuar raste të Tularemisë në grupmoshat 0–9 vjeç, 70–79 vjeç dhe 80 vjeç e lart. Për Toxoplazmozën, numri më i lartë i rasteve është vërejtur në grupmoshat 20–29 vjeç dhe 50–59 vjeç, me nga 2 raste secila dhe incidencë specifike përkatëse 0.58/100,000 dhe 0.99/100,000 banorë. Rastet e Toxoplazmozës janë raportuar edhe në grupmoshat 30–39 vjeç, 40–49 vjeç dhe 60–69 vjeç, me nga 1 rast. Në grupmoshat 0–9 vjeç, 10–19 vjeç, 70–79 vjeç dhe 80 vjeç e lart nuk janë regjistruar raste të kësaj sëmundje. (Graf. 13). Sipas gjinisë, Brucelloza me gjithsej 40 raste, shumica dërmuese janë raportuar te meshkujt (30 raste) krahasuar me femrat (10 raste). Kjo tregon një dominim të qartë të sëmundjes te gjinia mashkullore. Edhe për Tulareminë vihet re një shpërndarje e ngjashme sipas gjinisë, me gjithsej 12 raste, prej të cilave

8 raste te meshkujt dhe 4 raste te femrat, duke treguar dominim më të lartë te meshkujt. Sa i përket Toxoplazmozës, janë regjistruar gjithsej 7 raste, me një shpërndarje pothuajse të balancuar midis gjinive. Sa i përket trajtimit të rasteve me Brucellozë, 18 prej pacientëve kërkuan hospitalizim për shkak të gjendjes klinike, hospitalizimet zgjatën rreth 2-3 javë, ndërsa të tjerët u trajtuan ambulator, duke vazhduar trajtimin sipas protokolleve mjekësore pas lirimit nga spitali. Në përgjithësi, grupmoshat e mesme dhe të avancuara (30–69 vjeç) paraqesin barrën më të lartë të rasteve për të tre sëmundjet, ndërsa grupmoshat më të reja dhe më të vjetra shfaqen me numër më të ulët.

Si pjesë e hetimit epidemiologjik janë realizuar vizita të shumta në terren në familjet e prekura, veçanërisht në zonat rurale ku ka aktivitet blegtoral. Gjatë vizitave janë vlerësuar kushtet higjieniko-sanitare dhe praktikat e përditshme të familjeve, ku u identifikuan parregullsi të ndryshme, përfshirë kontakt të drejtpërdrejtë me produktet e abortit të kafshëve, konsumim të produkteve të qumështit të papasterizuar dhe mungesë të masave mbrojtëse. Për rastet ku kafshët rezultuan të infektuara, ato u asgjësuan sipas procedurave ligjore, ndërsa familjarëve iu dhanë këshilla mbi përdorimin e masave mbrojtëse, higjienën dhe paraqitjen e hershme të mjeku. rkatësisht 4 raste te meshkujt dhe 3 raste te femrat.

Grafikoni 12. Numri rasteve me sëmundje zoonotike, Incidenca /100,000 banorë sipas komunave janar-dhjetor 2025




Grafikoni 13. Numri i rasteve me sëmundje zoonotike, Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor 2025


Gjatë muajit shkurt 2025 është raportuar 1 rast me Hantan virus, nga komuna e Prizrenit (punëtor), i gjinisë mashkullore dhe i takon grup moshës 50-59 vjeç. Sipas hulumtimit epidemilogjik, rezulton se nuk ka qëndruar në ndonjë bjeshkë nga vendet endemike të Kosovës dhe mohon prezencën e brejtësve në vendbanimin e tij urban.

Ecuria e sëmundjeve që barten përmes vektorëve për periudhën, janar-dhjetor 2025

Gjatë vitit 2025, nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar: 19 raste me Borellozë që pasqyron numrin më të lartë të rasteve krahasuar me sëmundjet e tjera transmiseve apo Incidencë 1.04 raste/100,000 banorë. Numri më i madh i rasteve të Borrellozës është regjistruar në Prishtinë, me 12 raste, e cila njëkohësisht shfaq edhe një incidencë relativisht të lartë (5.78/100,000 banorë). Raste sporadike janë raportuar edhe në komunat Drenas, Lipjan, Obiliq, Ferizaj, Istog, Artanë dhe Vushtrri, ku incidenca varion nga 0.89 deri në 14.44 raste/100,000 banorë, me incidencën më të lartë të regjistruar në Artanë, pavarësisht numrit të ulët absolut të rasteve.



Vatrat sipas rasteve të raportuara me Borreliozë në Kosovë, 2025



Sa i përket Leishmaniazës, janë raportuar gjithsej 3 raste, me një incidencë të përgjithshme 0.16/100,000 banorë, duke treguar një përhapje shumë të kufizuar. Rastet janë regjistruar në komunat Prizren, Malishevë dhe Rahovec, secila me nga 1 rast, ndërsa incidenca specifike më e lartë vërehet në Malishevë (1.77/100,000) dhe Rahovec (1.72/100,000).

Ndërkohë, virusi i Nilit Perëndimor (WNV) është raportuar vetëm 1 rast, i regjistruar nga komuna e Pejës, me Incidencë 1.02/100,000 banorë, që tregon një qarkullim të virusit gjatë periudhës së studiuar.

Të dhënat e analizuara sipas grup-moshave: Borreliozë shfaqet në shumicën e grupmoshave, me numrin më të lartë të rasteve të regjistruara në grupmoshat 20–29 vjeç dhe 50–59 vjeç, secila me nga 4 raste. Incidenca më e lartë specifike për Borreliozën vërehet në grupmoshën 60–69 vjeç (2.15 raste/100,000 banorë), e ndjekur nga grupmosha 50–59 vjeç (1.98/100,000 banorë), çka tregon një rritje të riskut me avancimin e moshës. Në grupmoshat 30–39 vjeç, 40–49 vjeç dhe 60–69 vjeç janë raportuar nga 3 raste të Borreliozës me incidenca që variojnë nga 1.10 deri në 2.15 raste/100,000 banorë. Ndërkohë, numri më i ulët i rasteve është raportuar në grupmoshat 0–9 vjeç dhe 10–19 vjeç, me nga 1 rast.

Sa i përket Leishmaniazës, rastet janë raportuar në grupmoshat 0–9 vjeç, 10–19 vjeç dhe 60–69 vjeç, me nga 1 rast. Incidenca më e lartë specifike për këtë sëmundje vërehet në grupmoshën 60–69 vjeç (0.72 raste/100,000 banorë), ndërsa në grupmoshat më të reja incidenca mbetet më e ulët (0.37–0.34/100,000 banorë). Virusi i Nilit Perëndimor (WNV) është identifikuar te 1 rast, i cili i përket grupmoshës 0–9 vjeç, me një incidencë specifike 0.37 raste/100,000 banorë. (Tabela 7)

Tabela 7. Numri i rasteve me sëmundjet që barten përmes vektorëve dhe Incidenca/100,000 banorë gjatë vitit 2024 dhe 2025

Sëmundja	janar-dhjetor, 2024		janar-dhjetor, 2025	
	Nr i rasteve	Incidenca/100,000	Nr i rasteve	Incidenca/100,000
Borelioza	8	0.45	19	1.06
Leishmaniaza	1	0.06	3	0.17
WNV	7	0.39	1	0.06
Malaria	4	0.22	0	0

Gjatë vitit 2025, përmes mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse është raportuar 1 rast pozitiv me sëmundjen e Legjionarëve i konfirmuar në laborator me *Legionella pneumophila*. Rasti pozitiv ishte fëmijë i gjinisë mashkullore, grupmosha 0–1 vjeç, me vendbanim në fshatin Komogllavë – Ferizaj (fillimi i simptomave shtator 2025) me hospitalizim të përsëritur (3 episode). Pas hulumtimit epidemiologjik në terren, u identifikua si burim infeksioni ujë i ruajtur në bidon të mbushur nga çesma publike i cili rezultoi pozitiv për *L. pneumophila*. Pusi familjar rezultoi negativ për Legionella por jashtë standardeve bakteriologjike. Ndërkaq anëtarët e tjerë të familjes pas testimit për *L. pneumophila* rezultuan negativ. Poashtu nga institucionet shëndetësore ku ishte hospitalizuar indeks rasti nuk u raportuan raste të suspekta me sëmundjen e legjionarëve.

Me paraqitjen e këtij rasti incidenca vjetore e legionelozës në vitin 2025 vlerësohet rreth 0.06 raste për 100,000 banorë, çka tregon një nivel shumë të ulët të incidencës dhe mungesë të shpërthimeve epidemike komunitare.

Rastet e raportuar përmes rrjetit ELDSNet

Nga platformës EpiPulse/ELDSNet, gjatë vitit 2025 përmes pikave fokale vendore u njoftuan për 5 raste/shtetas të huaj të konfirmuara të legionelozës të cilët kishin raportuar se kishin qëndruar në resorte të ndryshme hotelierike të Kosovës. Këto raste përfshinin një shtetas norvegjez që kishte qëndruar në komunën e Pejës, dy shtetas gjermanë në Komunën e Ferizajt, një shtetas amerikan dhe një danez me qëndrim në komunën e Prizrenit.

Numri i rasteve të raportuara në skemën e mbikëqyrjes së lidhur me udhëtimet ishte për 67% më i lartë në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024.

Rezultatet e hulumtimit epidemiologjik dhe testimeve laboratorike tregojnë se *Legionella pneumophila* është izoluar vetëm në dy burime mjedisore specifike. Në objektet e tjera hoteliere të hulumtuara, mostrat e ujit rezultuan negative për praninë e *Legionella pneumophila*. Këto gjetje konfirmojnë se sistemet e ujit të ngrohtë dhe ruajtja e ujit në kushte joadekuate paraqesin faktorë kryesorë të rrezikut për ekspozim.

Masat e ndërmarra dhe rekomandimet

Në të gjitha rastet e raportuara janë zbatuar masa standarde të shëndetit publik, përfshirë hulumtimin epidemiologjik në terren, inspektimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të ajrit të kondicionuar, marrjen e mostrave për analiza laboratorike dhe informimin e subjekteve përkatëse për rrezikun dhe mënyrat e përhapjes së sëmundjes. Janë dhënë rekomandime për pastrimin dhe dezinfektimin e burimeve të ujit, kontrollin e temperaturës së ujit të ngrohtë, ruajtjen e nivelit adekuat të dezinfektantit dhe zbatimin e programeve të menaxhimit të ujit në objektet hoteliere dhe në sistemet e furnizimit me ujë.


Rritja e frekuencës turistike me zhvillimin hotelierik kërkon forcim të mbikëqyrjes dhe monitorimit. Gjithashtu, është theksuar rëndësia e edukimit shëndetësor të popullatës dhe stafit hotelier, raportimit të hershëm të rasteve të pneumonisë dhe monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së ujit, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim

Sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim të raportuara gjatë vitit 2025 në Kosovë, në bazë të diagnozës në numër më të lartë janë: diarea akute me 77,176 raste, helmimet me ushqim me 1,079 raste dhe gastroenterokolitet me 792 raste.


Në krahasim me vitin 2024, ku ishin raportuar 108,077 raste të diarresë akute, 1,102 raste të helmimeve ushqimore dhe 764 raste të gastroenterokoliteve, vërehet një ulje e rasteve që përhapen me ujë dhe ushqim. Rastet me diare akute kanë shënuar rënie për 28.6%, rastet e helmimeve me ushqim për 20%, ndërsa rastet e gastroenterokoliteve kanë shënuar rënie prej 35%. Kjo tregon një trend pozitiv të rënies së numrit të rasteve krahasuar me vitin e kaluar. (Graf.14).

Grafikoni 14. Rastet e sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim dhe Incidenca në 100,000 banorë sipas komunave, në periudhën janar - dhjetor 2025



Nga mostrat humane të testuara në Laboratorin e Mikrobiologjisë (IKShPK) dhe Laboratorin e Mikrobiologjisë Klinike (SHSKUK) patogjenët më të detektuar janë: Rotavirus me 84 izolate (38.9%), Adenovirus me 29 izolate (13.4%), Salmonella enteritidis me 33 izolate (15.3%), Clostridium difficile me 21 izolate (9.7%), Giardia lamblia me 26 izolate (12%), Enterovirus me 14 izolate (6.5%), Echinococcus me 3 izolate (1.4%), Norovirus me 1 izolat (0.5%), HAV me 2 izolate (0.9%), Entamoeba histolytica me 1 izolat (0.5%) dhe Enterobius vermicularis me 2 izolate (0.9%). Krahasuar me vitin 2024, Rotavirus ka shënuar një ulje të lehtë për 7.7%, Salmonella enteritidis ka pësuar rënie prej 28.3%, ndërsa Adenovirus ka shënuar rritje prej 38%. Clostridium difficile ka shënuar një rritje të lehtë për 5%, ndërsa Enterovirus, Norovirus, Echinococcus dhe Entamoeba histolytica kanë shënuar rënie. Giardia lamblia dhe HAV mbeten të qëndrueshëm, ndërsa Enterobius vermicularis u detektua për herë të parë në vitin 2025. Totali i izolateve nga mostrat humane ishte 233 në vitin 2024 dhe 216 në vitin 2025, duke treguar një ulje të përgjithshme prej 7.3%.(Graf 15).


Grafikoni 15. Rastet e konfirmuara në laboratorin e Mikrobiologjisë, në periudhën janar -dhjetor 2025



Sëmundjet vaksinëparandaluese


Nga ky grup i sëmundjeve gjatë vitit 2025 janë raportuar 209 raste me 72 raste me Morbill nga gjithesej 205 raste të testuara nga laboratorin mikrobiologjik i IKSHPK-së si raste të dyshimta apo të mundshme me Morbill. Rastet e konfirmuara me Morbill sipas komunave janë: Prishtinë (38 raste), Ferizaj (17 raste), Gjakovë (5 raste), Fushë Kosovë (4 raste), Lipjan dhe Malishevë me nga (2 raste) dhe Prizren, Shtime, Deçan dhe Kaçanik me nga 1 rast. (Graf 16 dhe 17).

Grafikoni 16. Numri i rasteve me Morbill, Incidenca/100,00 banorë sipas komunave janar-dhjetor 2025




Shpërndarja mujore e rasteve me Morbill gjatë vitit 2025 tregon rritje të rasteve në disa muaj të vitit, duke sugjeruar periudha me intensitet më të lartë të transmetimit. Kjo dinamikë kohore është në përputhje me rritjen e përgjithshme të rasteve të raportuara gjatë vitit 2025, si në nivel vendi ashtu edhe në rajon.

Grafikoni 17. Numri i rasteve të testuara dhe rastet pozitive me Morbill gjatë vitit 2025



Sipas grup-moshës: 0-1 vjeç (6 raste), 1-4vjeç (42 raste), 5-9 vjeç (16 raste), 9-18 vjeç (6 raste) dhe 18+ (2 raste).

Grafikoni 18. Numri i rasteve me Morbill sipas grup-moshave, janar-dhjetor 2025



Nga të gjitha rastet e konfirmuara me Morbill, 65 raste, pra 90,3 % kanë status vaksinal të pakompletuar , me 0 doza të MMR, 5 prej tyre me vetëm një doze MMR, kurse 2 raste të vaksinuar me 2 dozat e MMR. Sipas gjinisë, 55,6% (40 raste), i takojnë gjinisë mashkullore dhe 44,4% (32 raste) i takojnë gjinisë femërore.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025 janë raportuar 72 raste të konfirmuara pozitive me Morbill (Incidenca 4.05/100,000 banorë) dhe krahasuar me periudhën e njejtë të vitit 2024 me vetëm një rast me Morbill të importuar nga Arabia Saudite, vërehet një rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve. Gjatë kësaj periudhe kohore edhe vendet e rajoni janë ballafaquar me rritje të numrit të rasteve të raportuara me Morbill.

Me Parotit gjatë vitit 2025 janë raportuar gjithësj 18 raste, numër ky që krahasuar me periudhën e njejtë të vitit 2024 ku kanë qenë 27 raste të raportuara, vërehet një ulje e lehtë e numrit të rasteve për 33,3%. Shpërndarja sipas komunave: Prishtinë (6 raste), Vushtri (5 raste) dhe Drenas, Fushë Kosovë, Skenderaj, Malishevë, Gjakovë, Obiliq, Dragash me nga 1 rast. Nga rastet e konfirmuara 10 raste, 55,6% kanë status të pakompletuar vaksinal, 16,7%, statusi vaksinal nuk dihet dhe 27,7% status të kompletuar.

Nga 124 mostra të testuara për Pertussis gjatë vitit 2025 në laboratorin mikrobiologjik të IKSHPK-së janë konfirmuar gjithësj 29 raste pozitive me Pertussis (Incidenca 1.63/100,000

banorë) numër ky që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 ku kanë qenë 209 raste të konfirmuara, (Incidenca 11,72/100,000) vërehet një ulje e konsiderueshme e numrit të rasteve për 86,1%. Shpërndarja sipas komunave: Prishtinë (15 raste), Pejë (3 raste), Fushë Kosovë (3 raste), Istog (3 raste), Drenas (2 raste) dhe Mitrovicë, Podujevë, Vushtri me nga 1 rast. Nga 29 rastet e kofirmuara, 65,52% kanë status vaksinal të kompletuar, 28,58% kanë status vaksinal të pakompletuar dhe vetëm 6,89% kanë status vaksinal të panjohur.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025 nga 1,841 mostra të testuara në Rubellë janë konfirmuar vetëm 2 raste pozitive. Shpërndarja sipas komunave: Prishtinë dhe Drenas: me nga 1 rast. Sipas grupmoshave :1-4 (1 rast), 5-9 (1 rast). Sipas gjinisë: gjinisë femërore (1 rast), gjinisë mashkullore (1 rast). Statusi vaksinal i të dy rasteve është i pakompletuar.

4. HIV/AIDS dhe Infeksionet seksualisht transmise në Kosovë, 2024

Kosova është ndër vendet me prevalencën më të ulët të HIV-it, në mesin e popullatës së përgjithshme <1% dhe të popullatës kyçe <5% (meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM), personat që injektojnë drogë (PID) dhe punonjëset femra të seksit (PFS).

Përmes hulumtimit “Mbikëqyrja e integruar biologjike dhe e sjelljeve tek popullata kyçe në Kosovë, 2024” nuk u zbulua asnjë rast me HIV në mesin e personave që injektojnë droga (PID) dhe as në mesin e punëtoreve të seksit komercial (PFS), përderisa në mesin e popullatës kyçe MSM janë konfirmuar tri raste me HIV infektion dhe prevalenca e HIV tek kjo popullatë është 0.61%.

Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se ne nuk kemi epidemi të gjeneralizuar apo të përqendruar të HIV infektionit.


Mbikëqyrja e HIV/AIDS/IST ne Kosovë kërkon një monitorim dhe bashkëpunim të të gjitha njësive raportuese të sektorit shëndetësor publik dhe privat, pastaj te OJQ-ve të cilat zhvillojnë programe dhe aktivitete për HIV/AIDS, përkrahje të vendimmarrësve, mbështetje financiare, ngritje te kapaciteteve te resurseve humane dhe njëkohësisht mbikëqyrje të plotë të popullatës së përgjithshme dhe atyre ne rrezik te lartë (mbikëqyrje te sjelljeve).

Edhe pse Infeksionet që bartën me rrugë seksuale (IST) janë të përfshira në sistemin e rregullt të mbikëqyrjes së HIV/AIDS/IST në Kosovë, raportimet janë të mangëta dhe kualiteti i këtyre të dhënave është i ulët. Disponojmë me pak informacione sa i përket sjelljeve te rrezikshme, si p.sh. praktikat seksuale ose përdorimi i drogave injektuese tek PDI, MSM etj.

Ecuria e HIV/AIDS gjatë vitit 2025 në Kosovë


Nga viti 1986 - 2025 janë raportuar gjithsej 252 raste me HIV dhe AIDS me 58 raste që kanë vdekur si pasojë e AIDS-it. (Graf.19)

Grafikoni 19. Rastet HIV dhe AIDS në Kosovë, 1986-2025




Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas gjinisë, numri më i madh i takon gjinisë mashkullore (83%).(Graf.20)

Grafikoni 20. HIV dhe AIDS në Kosovë, sipas gjinisë 1986-2025




Grup mosha më e atakuar është 25-34 vjeç (34%) dhe 35-44 vjeç me 25%. (Graf.21.)

Grafikoni 21. Rastet HIV dhe AIDS sipas grup-moshës, 1986-2025




Transmisioni i HIV infeksionit përmes rrugëve të përhapjes: Rruga heteroseksuale 48% (121 raste), MSM 35% (89 raste), e panjohur 15% (38 raste), transmision vertikal 1% (2 raste) dhe PDI 1% (2raste). (Graf.22.)

Grafikoni 22. Rrugët e përhapjes së HIV infeksionit në Kosovë, 1986-2025



Numri më i madh i vdekjeve të raportuara sipas grup moshave është 25-34 vjeç 31% (18 raste), pastaj grup mosha 35-44 vjeç 29% (17 raste), (Graf.23.)

Grafikoni 23. Vdekjet sipas grup-moshave, si pasojë e AIDS, 1986-2025



Gjatë vitit 2025 janë raportuar gjithsej 37 raste me HIV/AIDS. Katër raste janë të gjinisë femërore dhe 33 raste i takojnë gjinisë mashkullore. Në grup moshën 15-24 vjeç janë 5 raste, 25-34 janë 14 raste, në grup moshën 35-44 vjeç janë 8 raste, 45-54 vjeç janë 5 raste dhe mbi 55 vjeç janë 4 raste.


Nga gjithsej 37 raste të raportuara, 12 raste (32%) rrugën e transmisionit e kanë heteroseksual, 20 raste (54%) i përkasin popullatës kyçe MSM dhe 5 raste (14%) janë me rrugë të transmisionit të panjohur.

Gjatë vitit 2025, janë raportuar 6 raste të vdekjes si pasojë e AIDS-it. Pesë raste të vdekjes i takojnë gjinisë mashkullore, dhe një gjinisë femërore.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST) gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 janë raportuar gjithsej 313 raste të Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme. Krahasuar me vitin paraprak 2024 (400 raste të raportuara), këtë vit kemi numër më të vogël të raportimit të rasteve me IST.

Grafikoni 24. Rastet e Infeksioneve seksualisht të transmetueshme, sipas komunave, janar-dhjetor 2025



Rastet e IST-ve analizuar sipas diagnozave, viti 2025

Analizuar sipas diagnozave gjatë vitit 2025 numri më i madh i rasteve të raportuara është me Chlamydia 183, Condyloma ano-gjenitale 87, Gonorrhea 24 etj. (Tabela 8)


Tabela 8. Rastet e IST-ve analizuar sipas diagnozave, janar-dhjetor 2025

Diagnoza	Gjithsej
Condyloma acuminata	87
Chlamydia trachomatis	183
Neisseria gonorrhoeae	24
Genital herpe	2
HPV	4
Mollusca contagiosum	3
Syphilis	10
Gjithsej	313

Rastet e IST-ve sipas grup moshës dhe gjinisë

Numri më i madh i rasteve të raportuara të IST-ve i takon grup moshës 25-49 vjeç me 226 raste (72%), pastaj kemi grup moshën 15-24 vjeç me 69 raste (22%). (Graf. 25)

Grafikoni 25. Rastet e IST-ve sipas grup-moshës dhe gjinisë, janar-dhjetor 2025



Rastet e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme gjatë vitit 2024, Kosovë (sipas diagnozave dhe komunave)

Në tabelën 9 është paraqitur ecuria e rasteve të IST-ve sipas diagnozave dhe komunave gjatë vitit 2025. Numri më i madh i rasteve është nga komuna Ferizaj 102 raste (98 Chlamydia, 3 Condyloma anogenitale dhe një rast HPV), komuna Pejë 58 raste (43 Chlamydia, 8 Gonorrhoea, 6 Condyloma etj), komuna Prishtinës 36 raste (28 Condyloma anogenitale, 3 raste Gonorrhoeae, 3 raste Syphilis dhe 2 Chlamydia), komunat e tjera kanë numër më të vogël të rasteve të raportuara.


Tabela 9. Rastet e IST-ve sipas diagnozave dhe komunave, janar-dhjetor 2025

Komunat	Diagnoza							Total
	Anogenital Condyloma	Chlamydia	Gonorrhoea	Genital herpes	Syphilis	Mollusca contagiosum	HPV	
Prishtinë	28	2	3		3			36
Giakovë	10	7	2	2			2	23
Pejë	6	43	8		1			58
Istog	1	1	1		1			4
Klinë	2	4	1					7
Deçan					2			2
Podujevë	2		2					4
Shtime	1	6						7
Shtërpe		4						4
Malishevë	1	1						2
Mitrovicë			1					1
Skënderaj	1							1
Vushtrri	2							2
Gjilan	3				1		1	5
Lipjan	3							3
Viti		5	1					6
F.Kosovë	3							3
Kaçanik		5						5
Komoran		1						1
Prizren	16	2	1		2	1		22
Mamushë	1							1
Rahovec	1	1	3					5
Suharekë	3	1	1			1		6
Dragash						1		1
Ferizaj	3	98					1	102
H.Elezit		2						2
Gjithsej	87	183	24	2	10	3	4	313

Rastet e IST-ve sipas gjinisë, 2025

Gjatë kësaj periudhe 69% (217) raste të raportuara i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 96 (31%) i përkasin gjinisë mashkullore (Graf. 26)

Grafikoni 26. Rastet e IST-ve sipas gjinisë, janar-dhjetor 2025



Rastet e IST-ve sipas gjinisë dhe diagnozës

Analizuar sipas gjinisë dhe diagnozës, gjatë vitit 2025, numri më i madh i rasteve të raportuara (181) i takon gjinisë femërore me shkaktarin *Chlamydia trachomatis*, 27 raste me *Condyloma acuminata*, kurse sa i përket gjinisë mashkullore numri më të madh i rasteve është me *Condyloma acuminata* 60, *Gonorrhoea* 21, *Syphilis* 10 etj (Tabela 10)

Tabela 10. Rastet e IST-ve sipas gjinisë dhe diagnozës

Diagnoza	Meshkuj	Femra	Gjithsej
<i>Condyloma acuminata</i>	60	27	87
<i>Chlamydia trachomatis</i>	2	181	183
<i>Neisseria gonorrhoeae</i>	21	3	24
Genital herpe	1	1	2
HPV	0	4	4
<i>Mollusca contagiosum</i>	2	1	3
<i>Syphilis</i>	10	0	10
Gjithsej	96	217	313

Ecuria e Hepatitit akut B, janar-dhjetor 2025

Gjatë kësaj periudhe kohore, në Kosovë janë raportuar gjithësej 23 raste me Hepatit akut B me Incidencë prej 1.29/100.000 banorë. Ky numër është më i ulët krahasuar me vitin 2024 (40 raste me Incidencë 2.24/100.000 banorë).


Sipas komunave rezulton se numri më i madh i rasteve të raportuara është nga komuna e Prizrenit (6 raste), Prishtina (5 raste), dhe me nga 1 rast komunat: Fushë-Kosovë, Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Pejë, Suharekë, Podujevë, Rahovec dhe Shtime.

Incidenca më e lartë e rasteve është raportuar nga komuna e Hanit të Elezit me 21/100.000 banorë, komuna e Fushë-Kosovës me nga 9/100.000 banorë, Mitrovica me 8/100.000 banorë, kurse komunat tjera me incidencë më të ulët (Graf.27)

Rastet e vdekjes me Hepatit B në Kosovë, 2025

Gjatë këtij viti është raportuar 1 (një) rast i vdekjes, femër moshë 50 vjeç me Hepatitis fulminans (Prishtinë).

Grafikoni 27. Numri i rasteve, Incidenca dhe Vdekjet/100,000 banorë me Hepatit akut B, janar - dhjetor 2025




Ecuria e sëmundjes sipas gjinisë

Gjatë kësaj periudhe me Hepatit akut B, sipas gjinisë rezultojn se kemi 61% apo (14 raste) të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore 39% apo (9 raste)

Ecuria e sëmundjes sipas grup moshave

Sa i përket grup - moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultojn se numri më i madh i rasteve i takon grup - moshës 60-69 vjeç me nga 21.7% (5 raste), e ndjekur nga grup-moshat 30–39 vjeç, 40–49 vjeç dhe 50–59 vjeç me nga 17.4% secila. Grup-moshat 20–29 vjeç dhe 70–79 vjeç përbëjnë nga 13.0% të rasteve, ndërsa nuk janë raportuar raste në grup-moshat 0–9 vjeç, 10–19 vjeç dhe ≥80 vjeç. Incidenca specifike më e lartë është regjistruar në grup-moshën 70–79 vjeç (3.74 raste për 100,000 banorë), e ndjekur nga grup-mosha 60–69 vjeç (3.58/100,000). (Graf. 28).

Grafikoni 28. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor 2025




Ecuria e Hepatit akut C në Kosovë, janar-dhjetor 2025

Gjatë kësaj periudhe kohore, në Kosovë janë raportuar gjithsej 8 raste me Hepatit akut C, me Incidencë prej 0.43/100.000 banorë. Ky numër është më i lartë krahasuar me vitin 2024 me Hepatit akut C (3 raste) me Incidencë prej 0.16/100.000 banorë.

Sipas komunave rezultojn se me nga 1 rast është raportuar në komunat e Prishtinës, Ferizajt, Gjakovës, Gjilanit, Pejës, Prizrenit, Podujevës dhe Vushtrrisë. Incidenca më e lartë e rasteve është raportuar nga komuna e Vushtrrisë 3/100.000 banorë. (Graf.29). Gjatë këtij viti nuk ka pasur asnjë rast të vdekjes të raportuar me Hepatit akut C.

Grafikoni 29. Numri i rasteve, Incidenca dhe Vdekjet/100,000 banorë me Hepatit akut C, janar - dhjetor, 2025




Ecuria e sëmundjes sipas gjinisë

Gjatë kësaj periudhe me Hepatit akut C, sipas gjinisë rezulton se kemi 62.5% apo (5 raste) të gjinisë femërore dhe të gjinisë mashkullore 37.5% apo (3 raste).

Ecuria e sëmundjes sipas grup moshave

Sa i përket grup - moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numër më i lartë i rasteve i takojnë grup moshave 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga 37.5% secila (me nga 3 raste). Grup-moshat 20-29 vjeç dhe 30-39 vjeç përbëjnë nga 12.5% të rasteve (me nga 1 rast), ndërsa në grup-moshat e tjera nuk janë raportuar raste. Incidenca specifike më e lartë është regjistruar në grup-moshën 60-69 vjeç me 2.15/100.000 banorë. (Graf. 30)

Grafikoni 30. Numri i rasteve me Hepatit C dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor 2025



5. Vaksinimi në Kosovë, janar-dhjetor 2025

Programi i zgjeruar i imunizimit (PZI) konsiderohet si proces i suksesshëm në kuadër të fushës së shëndetit publik në Kosovë. Një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) është edhe zbatimi i PZI me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse vaksinë parandaluese duke synuar përfshirjen e plotë të të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë në Republikën e Kosovës.

Ministria e Shëndetësisë (MSh) siguron qëndrueshmëri financiare për PZI përmes sigurimit të vaksinave. Në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) si mbikëqyrës i zbatimit të programit dhe Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) si institucione zbatuese, është siguruar qëndrueshmëria e këtij programi, në përgjithësi. Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRShP) janë përgjegjëse për analizën e të dhënave të grumbulluara dhe monitorimin e performancës së imunizimit dhe raportimin e tyre.


Në vitin 2025 vërehet një përmirësim i dukshëm i mbulueshmërisë së vaksinimit në foshnjëri, veçanërisht për vaksinat e lindjes dhe dozat e para të skemës bazë, duke reflektuar funksionim më të mirë të shërbimeve të imunizimit dhe ndjekje më të rregullt të fëmijëve në vitin e parë të jetës. Megjithatë, dozat përforcuese dhe vaksinimi i fëmijëve mbi moshën 1 vjeç vazhdojnë të paraqesin mbulim të pamjaftueshëm, çka tregon vështirësi në vazhdimësinë e skemës së plotë të vaksinimit dhe nevojën për ndjekje më aktive nga shërbimet shëndetësore.

Një shqetësim i veçantë për shëndetin publik paraqitet rënia e mbulueshmërisë së vaksinës MMR në grupmoshën 12–24 muaj, e cila rrit rrezikun për shpërthime të fruthit dhe sëmundjeve të tjera të parandalueshme me vaksinë. Paralelisht, adoleshentët e moshës 11–18 vjeç vazhdojnë të mbeten një grup me akses dhe pranueshmëri të kufizuar ndaj vaksinimit, gjë që reflektohet në nivele mbulimi nën objektivat e rekomanduara dhe kërkon ndërhyrje të synuara sensibilizuese dhe organizative..

Kalendari i rregullt i vaksinimit për vitin 2025, përfshin 13 antigjene që mbrojnë kundër sëmundjeve vaksinë-parandaluese, duke reduktuar ndjeshëm rrezikun e sëmundshmërisë, komplikimeve dhe vdekshmërisë, veçanërisht te fëmijët. Zbatimi i plotë i këtij kalendari kontribuon në krijimin e imunitetit kolektiv, parandalon përhapjen e sëmundjeve dhe garanton një nivel të lartë sigurie shëndetësore për gjithë popullatën.

Fëmijë plotësisht të vaksinuar konsiderohen ata që në moshën 0 deri në 24 muaj muajshe kanë marrë 1 dozë BCG, 3 doza Hepatit B, DTP, Hib, PCV, 2 doza Rota dhe 1 dozë MMR.

Grafikoni 31. Mbulueshmëria me vaksinë për moshat 0-24 muaj, në nivel vendi, 2025



Të dhënat e paraqitura në grafikun 31, tregojnë një përmirësim të përgjithshëm të mbulueshmërisë me vaksinim në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 për shumicën e antigjeneve të kalendarit të rregullt. Vërehet rritje e dukshme të dozave bazë të DTaP-IPV-Hib (doza 1, 2 dhe veçanërisht doza 3, nga 80% në 90%), si dhe të vaksinave Rota, PCV dhe doza përforcuese DTaP-IPV-Hib-R1, e cila shënon rritje nga 52% në 66%. Një përmirësim i konsiderueshëm evidentohet edhe të PCV3, nga 60% në 82%, duke reflektuar përpjekje të shtuara për plotësimin e skemës së vaksinimit. Përkundrazi, në MMR1, ku vërehet një rënie e mbulueshmërisë nga 89% në 82%, çka tregon nevojën për analiza shtesë dhe ndërhyrje të synuara për rritjen e vaksinimit kundër fruthit, shtytave dhe rubellës. Në tërësi, trendi pozitiv në vitin 2025 dëshmon për forcimin e shërbimeve të imunizimit, ndërgjegjësimin më të madh të popullatës dhe angazhimin institucional për rritjen e mbrojtjes ndaj sëmundjeve vaksinë-parandaluese.

Tabela 11. Mbulueshmëria me vaksinë sipas kalendarit të rregullt në nivel vendi

Mosha	Antigjenet	Mbulueshmëria % 2024	Mbulueshmëria % 2025
0-11 muaj	BCG/HepB1	96	99
	Hep2	92	94
	Hep3	80	90
	DTaP1/Hib1/IPV1	96	99
	DTaP2/Hib2/IPV2	91	95
	DTaP3/Hib3/IPV3	80	90
	Rota 1	92	94
	Rota 2	86	89
	PCV 1	96	98
	PCV 2	90	94
12-24 muaj	MMR	89	82
	PCV 3	60	82
	DTaP R1/Hib R1/IPV R1	52	66
6-7 vjeç	bOPV-R2	94	94
	DT-R2	94	94
	MMR-R	94	94
11-12 vjeç	bOPV-R3	88	88
	dT-R3	88	88
	HPV (dy gjinitë)	85	87
17-18 vjeç	dT	82	83

*Mbulueshmëria ne nivel vendi është 90 (duke llogaritur DTaP1, DTaP3, MMR1).

Vaksinimi kundër gripit sezonal

Bazuar në planifikimet e IKShPK-së, MSh për sezonën e gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës kundër gripit sezonal, prej të cilave përmes Sistemit të menaxhimit të stokut farmaceutik (SMSF) janë shpërndarë në të gjitha Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) të cilat më tutje kanë bërë shpërndarjen e vaksinave në njësitë e tyre vartëse ku ofrohen shërbimet e vaksinimit (Qendra të Mjekësisë Familjare/QMF dhe Ambulantat e Mjekësisë familjare / AMF).

Gjatë sezonës 2024/2025 janë administruar gjithsej 68,632 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 45,950 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 21,140 me sëmundje kronike, 1,502 profesionistë shëndetësor, 3 gra shtatëzëna dhe 37 fëmijë (0-5 vjeç). Derisa gjatë sezonës 2025/2026 deri më 31 dhjetor 2025, janë administruar gjithsej 75,872 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 44,347 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 29,700 me sëmundje kronike, 1,287 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 49 fëmijë (0-5 vjeç), 195 zyrtarë policorë dhe 30 mësimdhënës dhe të tjerë 258. Vaksinimi kundër gripit sezonal është duke vazhduar në të gjitha komunat e Kosovës dhe gjatë janarit është vërejtur një rritje e kërkesës për vaksinim kundër gripit sezonal që korrespondon me rritjen e rasteve me grip.

Vaksinimi kundër tetanusit me indikacion

Sipas të dhënave rezultojnë se 13,431 persona kanë marrë dozën e parë, çka tregon një numër të lartë individësh të ekspozuar ndaj rrezikut pas lëndimeve dhe nevojën për mbrojtje të menjëhershme. Numri i të vaksinuarve bie ndjeshëm në dozat pasuese, me 2,138 persona që kanë marrë dozën e dytë dhe 1,279 dozën e tretë, duke reflektuar faktin se jo të gjithë të lënduarit kanë nevojë për kompletimin e skemës së plotë ose se disa kanë pasur vaksinime të mëparshme. Rivaksinimi është kryer te 25 persona, çka tregon për ndjekjen e rasteve specifike ku kërkohet përforcimi i imunitetit. Në total janë administruar 16,873 doza vaksinash, një tregues i qartë i rolit të rëndësishëm të shërbimeve shëndetësore në parandalimin e tetanusit dhe në ofrimin e mbrojtjes adekuate për popullatën në rast lëndimesh.

Vaksinimi kundër Hepatiti B me indikacion

Gjatë periudhës raportuese, gjithsej janë vaksinuar 3,342 persona kundër hepatitit B. Nga të dhënat rezultojnë se grupi me numrin më të madh të të vaksinuarve është ai i punëtorëve shëndetësorë, ku 857 persona kanë marrë dozën e parë, 645 dozën e dytë, 477 dozën e tretë, ndërsa 70 persona kanë marrë dozë rikujtuese. Kjo pasqyron prioritetin e lartë të mbrojtjes së këtij grupi për shkak të ekspozimit të vazhdueshëm profesional ndaj rrezikut biologjik. Në grupin e kontakteve familjare të personave HBsAg pozitiv, janë vaksinuar 160 persona me dozën e parë, 129 me dozën e dytë dhe 81 me dozën e tretë, ndërsa vetëm 3 persona kanë përfituar dozë rikujtuese, duke treguar nevojën për forcimin e ndjekjes së skemës së plotë të vaksinimit.

Ndër personat me sëmundje kronike të mëlçisë ose hepatit C, vaksinimi ka qenë më i kufizuar, me 29 persona të vaksinuar me dozën e parë, 14 me dozën e dytë dhe 9 me dozën e tretë, pa administrim të dozës rikujtuese.

Për personat që udhëtojnë jashtë shtetit, janë administruar 315 doza të para, 122 doza të dyta dhe 38 doza të treta, si dhe 4 doza rikujtuese, çka tregon interes për mbrojtje para udhëtimeve, por gjithashtu një nivel relativisht të ulët të përfundimit të serisë së plotë. Në grupet e tjera të rrezikut janë vaksinuar 149 persona me dozën e parë, 147 me dozën e dytë, 86 me dozën e tretë dhe 9 persona kanë marrë dozë rikujtuese. Në përfundim, të dhënat tregojnë se vaksinimi kundër hepatitit B ka qenë i përqendruar kryesisht tek grupet profesionale dhe familjare me rrezik të lartë, megjithatë vihet re një rënie progresive e numrit të personave që përfundojnë serinë e plotë të dozave. Kjo nënvizon nevojën për forcimin e këshillimit shëndetësor, ndjekjen aktive të personave të vaksinuar dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e kompletimit të skemës së vaksinimit.

Vaksinimi kundër Rabiesit me indikacion

Vaksinimi kundër rabiesit është një masë thelbësore e shëndetit publik, pasi rabiesi është një sëmundje virale pothuajse gjithmonë fatale sapo të shfaqen simptomat. Edhe pse në vendin tonë nuk janë raportuar raste të tërbimit të njerëzit apo kafshët për më shumë se tri dekada, rreziku potencial vazhdon të ekzistojë për shkak të lëvizjeve ndërkufitare të kafshëve. Nga të dhënat rezulton se 295 persona kanë marrë dozën e parë, ndërsa numri zvogëlohet gradualisht në dozat pasuese: 218 persona kanë marrë dozën e dytë, 169 dozën e tretë dhe 124 dozën e katërt. Në total janë administruar 806 doza vaksinash. Kjo rënie progresive e numrit të personave në dozat e mëvonshme është e pritshme, pasi skema e vaksinimit përfshin disa doza dhe jo të gjithë të vaksinuarit e përfundojnë të gjithë ciklin brenda të njëjtës periudhë raportimi. Megjithatë, numri i konsiderueshëm i dozave të administruara tregon një angazhim të vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore për parandalimin e rabiesit dhe zbatimin rigoroz të protokolleve të sigurisë pas kafshimeve nga kafshë me rrezik.

Vaksinimi sipas trafikut ndërkombëtar

Vaksinimi sipas trafikut ndërkombëtar është realizuar në mënyrë të plotë, duke u mbuluar të gjitha kërkesat për vaksinim të qytetarëve që kanë udhëtuar ose planifikuar të udhëtojnë në vende endemike për sëmundje të caktuara. Përmes sigurimit në kohë të vaksinave përkatëse dhe zbatimit të protokolleve ndërkombëtare të imunizimit, është garantuar mbrojtje shëndetësore adekuate për udhëtarët, si dhe parandalimi i importimit të sëmundjeve infektive në vend.

6. Situata epidemiologjike me COVID-19

Situata epidemiologjike globale


Rastet globale: Sipas të dhënave të fundit të OBSH-së, që nga 31 dhjetor 2019 deri më 31 dhjetor 2025 janë raportuar gjithsej 779,034,940 raste të COVID-19 dhe 7,107,666 raste të vdekjes dhe janë administruar 13.64 miliardë doza të vaksinës kundër COVID-19.

Situata epidemiologjike në Kosovë nga fillimi i pandemisë

Nga data 08.02.2020 deri më 31.12.2025, u testuan gjithsej 2,010,260 mostra të rasteve të dyshimta për virusin SARS-CoV-2.

Me SARS-CoV-2 janë diagnostikuar gjithsej 276,299 raste, ose 13.74% e mostrave të testuara. Deri më 31.12.2025, janë shëruar 273,060 raste, ose 98.83% e të infektuarve. Deri më 31.12.2025, janë regjistruar gjithsej 3,238 raste të vdekjes me një shkallë letaliteti prej 1.17%.


Grafikoni 32. Rastet e konfirmuara, shëruara dhe vdekjet nga COVID-19 në Kosovë, 2020-2025



Situata epidemiologjike me COVID-19, janar-dhjetor 2025


Gjatë vitit 2025 (01.01.2025–31.12.2025), nga 6,069 mostra të testuara te personat e dyshimtë për virusin SARS-CoV-2, u konfirmuan 125 raste pozitive. Sipas grupmoshave, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grupmoshës 0–9 vjeç, me 35 raste.

Grafikoni 33. Numri i rasteve të dyshimta dhe rastet COVID-19, janar-dhjetor 2025




Gjatë vitit 2025 prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas komunave rezulton se numri më i madh i rasteve është raportuar komuna e Prishtinës (68 raste), e ndjekur nga komuna e Ferizajit dhe komuna e Fushë Kosovës (me nga 9 raste) kurse incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë (morbidity) është raportuar nga komuna e Prishtinës dhe e Fushë Kosovës.

Grafikoni 34. Numri i rasteve me COVID-19, Incidenca sipas komunave janar-dhjetor 2025



Gjatë vitit 2025 nga rastet e konfirmuara me COVID-19, sipas grupmoshave, rezultojnë se numri më i madh i rasteve i takon grup-moshave 0–9 vjeç (35 raste) dhe 50–59 vjeç (23 raste) ndërsa numri më i vogël i rasteve i takon grup-moshës 80+ vjeç, me 2 raste. Sipas incidencës specifike për grup-moshë, rezultojnë se grupmosha më e prekur është ajo 0–9 vjeç, me 35 raste/100,000 banorë. Moshja mesatare e rasteve të konfirmuara gjatë vitit 2025 ishte 34.3 vjeç kurse sipas gjinisë, rezultojnë se gjinia femërore përfaqëson 58.4% të rasteve (73 raste), ndërsa gjinia mashkullore përfaqëson 41.6% (52 raste).

Grafikoni 35. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë në Kosovë gjatë vitit 2025



7. Rastet e vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, 2025

Tabela 12. Rastet e vdekjeve të raportuara në Kosovë, sipas diagnozave klinike

<i>Diagnoza</i>	<i>Numri i rasteve të vdekjeve të raportuara</i>
<i>Meningoencephalitis ac. (me diagnozë përcjellëse)</i>	6
<i>Meningoencephalitis ac. Purulenta</i>	4
<i>Meningitis ac.</i>	2
<i>Bronchopneumonia, me diagnozë përcjellëse</i>	13
<i>Gastroenterocolitis (me diagnozë përcjellëse)</i>	2
<i>Infiltratio pulmonum</i>	39
<i>Influenza A me diagnozë përcjellëse</i>	6
<i>Hepatitis fulminant me diagnozë përcjellëse</i>	1
<i>Hepatitis chronica B me diagnoza përcjellëse</i>	1
<i>HIV/AIDS</i>	2
<i>COVID-19 me diagnozë përcjellëse</i>	1
<i>Gjithsej</i>	77

Në periudhën janar-dhjetor 2025, numri i rasteve të vdekjeve të raportuara nga sëmundjet ngjitëse ka arritur në 77 raste, duke shënuar një rënie krahasuar me periudhën e mëparshme. Nga këto raste, numri më i lartë i vdekjeve është nga: Infiltratio pulmonum dhe Bronchopneumonia me 39 raste respektivisht 13 raste, pasuar nga Meningoencephalitis ac. (me diagnozë përcjellëse) me 6 raste të vdekjes dhe Influenza A me 6 raste të vdekjes. (shih Tabelën 12).

8. Ecuria e epidemive të lajmëruara në Kosovë gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 janë raportuar gjithsej 14 shpërthime. Prej tyre, 10 (71%) i përkasin helmimeve ushqimore, ndërsa 4 (29%) rasteve të Brucelozës. Numri i përgjithshëm i personave të ekspozuar ishte 1,533, nga të cilët 141 u sëmurën dhe 65 kërkuan hospitalizim, shkalla mesatare e sulmit: ~9.1% Helmimet ushqimore përbënin shumicën e shpërthimeve dhe u raportuan në disa komuna, duke përfshirë Ferizaj, Prishtinë, Gjilan, Podujevë, Pejë dhe Shtime. Shkalla e sulmit varionte nga 2.0% deri në 50%, me formën më të rëndë të shpërthimit në Gjilan-hospitalizim i lartë (15/20), Prishtinë –23 të hospitalizuar nga 31 të sëmurë, Ferizaj (13/39), duke reflektuar ekspozim intensiv dhe nevojë për masa të menjëhershme parandaluese. Rastet e Brucelozës u raportuan në Istog, Rahovec dhe Vushtrri dhe ishin të lidhura me kontaktin me kafshë ose produkte shtazore të pakontrolluara.

Shpërthimet ushqimore ishin kryesisht të lidhura me konsumimin e ushqimit të kontaminuar, ndërsa bruceloza u transmetua përmes kontaktit direkt me kafshë ose produkte të tyre.

Shkaktari më i shpeshtë i izoluar në ushqim/koprokulturë, ishte *Salmonella enteritidis* (më dominante), e ndjekur nga *Staphylococcus aureus* dhe *Escherichia coli*, çka tregon për mangësi në higjienën ushqimore dhe sanitare. Në disa shpërthime, rezultatet laboratorike ishin negative ose nuk u morën mostra, duke kufizuar identifikimin e saktë etiologjik.

Në mjetet e punës/ambient/personel, janë izoluar kryesisht *Escherichia coli*, *Staphylococcus aureus*, *Enterococcus spp.* dhe *Klebsiella pneumoniae*, çka tregon për mangësi serioze në higjienë, sidomos kontaminim fekal dhe nga duart e personelit.


Pas identifikimit të shpërthimeve janë ndërmarrë masa si: izolimi i rasteve, kontrolli sanitar i objekteve ushqimore, ndalimi i përkohshëm i punës në disa lokale, dezinfektimi i ambienteve dhe edukimi shëndetësor i personelit.

Krahasuar me epidemitë e lajmëruara gjatë vitit 2024, të raportuara kanë qenë 17 epidemi, prej tyre 9 epidemi kolektive dhe 8 epidemi familjare. Të ekspozuar kanë qenë 687 persona, prej tyre të sëmurë 148 raste (shkalla e sulmit 21.5%) dhe të hospitalizuar 51 raste (34.4%). Të gjitha epidemitë janë hulumtuar dhe janë përpunuar nga stafi i IKShPK në bashkpunim me QRShP, AUV dhe Inspektorati sanitar komunal.

Ecuria e epidemive të paraqitura në Kosovë sipas muajve, 2025

Sa i përket sezonalitetit të paraqitjes së epidemive, gjatë vitit 2025, numër më i lartë i epidemive janë paraqitur gjatë muajit gusht gjithsej 5 epidemi (3 epidemi kolektive dhe 2 epidemi familjare), gjatë muajit tetor janë paraqitur 3 epidemi familjare, kurse gjatë muajve tjerë janë raportuar nga 1 epidemi kolektive përveq muajit qershor ku na ka pasur asnjë epidemi të paraqitur. (Graf.36).


Grafikoni 36. Numri i rasteve me helmim me ushqim gjatë periudhës janar-dhjetor, 2025



Ecuria e epidemive në Kosovë sipas grup moshave dhe gjinisë

Sa i përket grup- moshës tek rastet e anketuara, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup moshë më e atakuar është 10-19 vjeç me 27% (38 raste), grup moshë 30-39 vjeç me 24% (34 raste), 20-29 vjeç me 22.6% (32 raste), grup moshat 40-49 vjeç me 13.4% (19 raste), grup moshat 0-9 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga 4.2% (6 raste), grup moshë 59-59 vjeç me 2.8% (4 raste), grup moshat 70-79 vjeç me 1.4% (2 raste), kurse grup moshë mbi 80 vjeç me asnjë rast të raportuar (Graf.37) dhe sipas gjinisë rezulton se kemi 56.7% (80 raste) të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore 43.2% (61 raste).

Grafikoni 37. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor, 2025



Konkluzionet

Situata epidemiologjike gjatë vitit 2025 tregon nevojën për një qasje më proaktive në parandalimin e helmimeve ushqimore dhe sëmundjeve zoonotike. Bazuar në HACCP (Analiza e rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit) nuk është zbatuar kontrolli i rrezeve të sigurisë ushqimore dhe zbatimi i praktikave higjienike në të gjithë linjën e prodhimit të ushqimit. Hetimet vunë në dukje gabime të mundshme në praktikën higjienike në kontekstin e shfaqjes së higjienës joadekuate të duarve të personelit që shërbenin ushqim, menaxhimit të dobët të lavanderisë dhe higjienës joadekuate të ambientit të punës. Gjetjet laboratorike dhe epidemiologjike treguan se burimi i shpërthimit në 75% të epidemive ishte sosi i majonezës. Salmonella Enteritidis, shpesh e lidhur me vezë të kontaminuara, mund të jetë futur në majonezë. Zbulimi i Staphylococcus aureus u identifikua në shtupa të marra nga duart e mbajtësit të ushqimit kjo thekson rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në zonat e përgatitjes së ushqimit. Faktorët kontribuues përfshinin ruajtjen e papërshtatshme të ushqimit, përgatitjen jo-higjienike, mungesën e trajnimit të personelit dhe mosrespektimin e standardeve sanitare. Në rastet e Brucelozës, faktor kyç ishte konsumimi i produkteve të qumështit të pa pasterizuara. Shpërthimet e raportuara patën ndikim të konsiderueshëm në shëndetin publik, veçanërisht për shkak të numrit të lartë të hospitalizimeve në disa komuna. Kjo situatë paraqet barrë shtesë për shërbimet shëndetësore dhe kërkon ndërhyrje të koordinuar. Zbatimi i rekomandimeve të propozuara do të kontribuonte në reduktimin e shpërthimeve dhe përmirësimin e sigurisë shëndetësore.

Digjitalizimi i Sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse (SMSN)

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka mandat monitorimin e sëmundjeve ngjitëse përmes Sistemit digjital të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN). Gjatë vitit 2025 janë realizuar vizita monitoruese dhe takime koordinuese me qëllim të përmirësimit të raportimit përmes sistemit të digjitalizuar.

Gjatë periudhës së parë të vitit 2025 janë identifikuar mangësi në raportim, kryesisht mospërputhje të diagnozave ICD-10 me listën e sëmundjeve ngjitëse, të cilat janë adresuar dhe përmirësuar. Një numër i konsiderueshëm komunash nuk kanë raportuar fare përmes SMSN, ndërsa disa raportojnë vetëm me kopje fizike. Komunitet me shumicë serbe në pjesën më të madhe nuk raportojnë as në mënyrë digjitale dhe as manuale.

Në kujdesin parësor, edhe pse 17–38 komuna raportojnë përmes SMSN gjatë periudhave të ndryshme, numri i rasteve të raportuara është dukshëm më i ulët krahasuar me kopjet fizike, duke treguar nënraportim. Vetëm disa komuna raportojnë përmes SMSN.

Në kujdesin dytësor dhe tretësor, raportimi përmes SMSN është i kufizuar: vetëm disa spitale dhe klinika raportojnë rregullisht, ndërsa shumica vazhdojnë të mbështeten në kopje fizike. Klinika Infektive në QKUK mbetet raportuesja më e rregullt, ndërsa klinikat e tjera raportojnë numër të ulët rastesh. Gjatë vitit 2025 ka filluar dhe vazhduar raportimi edhe nga disa institucione private shëndetësore.

Gjatë gjithë vitit është vërejtur rritje graduale e raportimit përmes SMSN, veçanërisht në periudhën korrik–shtator, ku përqindja mujore e raportimit ka arritur deri në rreth 29%. Në periudhën tetor–dhjetor 2025, raportimi përmes SMSN ka arritur një trend mesatar prej 24.13% krahasuar me kopjet fizike, duke treguar vazhdimësi dhe progres në implementimin e sistemit.

SMSN është në proces të avancimit, por vazhdojnë të ekzistojnë sfida të rëndësishme si nënraportimi, mungesa e infrastrukturës dhe mospjesëmarrja e disa institucioneve, duke kërkuar angazhim të vazhdueshëm institucional për funksionalizim të plotë të sistemit.

9. Rekomandimet

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Inspektorët shëndetësor dhe sanitar të bëjnë mbikëqyrjen e sistemit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse, bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200 për mënyrën e regjistrimit/raportimit të sëmundjeve ngjitëse në të gjitha Institucionet shëndetësore.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave dhe pasqyrës reale të situatës epidemiologjike në kohë reale për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

Sëmundjet zoonotike dhe ato që përcillen nga vektorët në Kosovë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse, prandaj rekomandojmë bashkëpunimin ndërsektorial me qasjen “Një shëndet”.

Të ketë bashkëpunim të plotë në mes të IKSHPK me QKUK-Klinikën Infektive, Pediatrike, Pulmologjike, Dermatovenrologjike, QKTGJ dhe me të gjitha nivelet tjera të cilat janë përgjegjëse për raportimin e rasteve me sëmundje ngjitëse.



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: Rr.Instituti shëndetësor,No.12, 10000 Prishtinë

WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>

Telefoni:+38338 551432

